



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KURRIKULAVE

Nr. 780/1 Prot.

Tiranë më 12/05 2021

Lënda: Për marrjen e masave për mbarimin e vitit akademik 2020-2021
Drejtuar: Fakultetit të Arhitekturës dhe Urbanistikës
Administratorit të UPT

Këtu

Bashkëngjitur, po Ju përcjellim shkresën Nr.2668/1, datë 10.5.2021, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për marrjen e masave nga institucionet e arsimit të lartë për mbarimin e vitit akademik 2020-2021" si dhe Urdhrin Nr. 2668, datë 10.5.2021, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për marrjen e masave për mbarimin e vitit akademik 2020-2021 nga institucionet e arsimit të lartë".

Lutemi fakulteteve që brënda datës 18.5.2021 të hartojnë dhe të paraqesin pranë Rektoratit, planin e masave organizative dhe administrative, sipas përcaktimeve të këtij urdhri, në të cilin përfshijnë, numrin e saktë të studentëve që planifikohen të frekuentojnë institucionin dhe sipërfaqet në dispozicion të shprehur në m², me qëllim garantimin e distancimit social të studentëve dhe stafit akademik.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,




REKTORI

Prof. Dr. Andrea MALIQARI

Malikari

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE DHE
PËRPUTHSHMËRISË PËR ARSIMIN, SPORTIN DHE RININË
DREJTORIA E PROGRAMIMIT, STANDARDIZIMIT DHE HARMONIZIMIT
TË KUADRIT RREGULLATOR

Nr. 2668/prot.
1

Tiranë, më 10.5. 2021

Lënda: Për marrjen e masave nga institucionet e arsimit të lartë për mbarimin e vitit
akademik 2020-2021

UNIVERSITETIT TË TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.3, Tiranë

UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza" Nr. 4, Tiranë

UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË

Adresa: Rruga e Dibrës, Nr. 371, 1005, Tiranë

UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS

Adresa: Rruga "Pajsi Vodica", Kodër Kamëz, Tiranë

UNIVERSITETIT TË ARTEVE, TIRANË

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 2, Tiranë

UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS

Adresa: Rruga "Muhamet Gjollesha", Tiranë

UNIVERSITETIT TË SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

Adresa: Sheshi "2 Prilli", nr. 24, Shkodër

UNIVERSITETIT TË ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

Adresa: Rruga "Ismail Zyta", Elbasan

UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË

Adresa: Skelë, Rruga "Kosova", 9401, Vlorë

UNIVERSITETIT "FAN S. NOLI", KORÇË

Adresa: Bulevardi "Rilindasit 1", Korçë

UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTËR

Adresa: Rruga "Studenti 30", Gjirokastër

UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës

Adresa: Rruga "Curila", nr.14, 2001, Durrës

AKADEMISË SË STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE, TIRANË

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë

AKADEMISË SË FORCAVE TË ARMATOSURA

Adresa: Rruga "Odhise Paskali", Tiranë

AKADEMISË SË SIGURISË

Adresa: Rruga e Elbasanit, Tiranë

UNIVERSITETIT "NEW YORK", TIRANË

Adresa: Rruga "Kodra e Diellit", Selitë, Tiranë

UNIVERSITETIT "LUARASI"

Adresa: Rruga "Dritan Hoxha", nr. 127/1, Tiranë

UNIVERSITETIT "ALBANIAN UNIVERSITY"

Adresa: Bulevardi "Zogu I", 1001, Tiranë

UNIVERSITETIT KATOLIK "ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË"

Adresa: Laprakë, Rruga "Dritan Hoxha", Tiranë

AKADEMISË SË FILMIT DHE MULTIMEDIAS "MARUBI"

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", nr. 78, Tiranë

UNIVERSITETIT "BARLETI"

Adresa: Rruga "Samë Frashëri", nr. 41, Tiranë

UNIVERSITETIT EUROPIAN TË TIRANËS

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd. 70 H.1, Njësia Bashkiake Nr. 7, Tiranë

KOLEGJIT UNIVERSITAR "WISDOM"

Adresa: Rruga "Medar Shtylla", Tiranë

UNIVERSITETIT "ALDENT"

Adresa: Rruga e Dibrës, Tiranë

UNIVERSITETIT "POLIS"

Adresa: Rruga "Bylis 12", Autostrada Tiranë-Durrës, Km 5, Kashar, SH2, Tiranë

UNIVERSITETIT "EPOKA"

Adresa: Autostrada Tiranë-Rinas, km. 12, Tiranë

**INSTITUCIONIT PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË "SHKOLLA E LARTË
NEHEMIA"**

Adresa: Rruga "Nehemia", 7304, Buçimas, Pogradec

UNIVERSITETIT MESDHETAR TË SHQIPËRISË

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", nr. 52, Tiranë

KOLEGJIT UNIVERSITAR "PAVARËSIA", VLORE

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 23, AL 1001, Tiranë E-mail: info@arsimi.gov.al www.arsimi.gov.al

Adresa: Bulevardi "Ismail Qemali", Vlorë

KOLEGJIT UNIVERSITAR "LOGOS"

Adresa: Pallati i Sportit "Asllan Rusi", Rr. "Dritan Hoxha", Pallatet Komfort, Tiranë

UNIVERSITETIT "METROPOLITAN TIRANA"

Adresa: Rruga "Pjetër Budi", Tiranë

KOLEGJIT UNIVERSITAR "TBU"

Adresa: Rruga "Vaçe Zela", Tiranë

KOLEGJIT UNIVERSITAR "BEDËR"

Adresa: Kompleksi Ushuga, Rruga "Jordan Misja", Tiranë

KOLEGJIT UNIVERSITAR "REALD"

Adresa: Rruga "Zahir Pajaziti", Vlorë

KOLEGJIT UNIVERSITAR TË BIZNESIT

Adresa: Rruga "Vangjel Noti", Nr. 25, Laprakë, Tiranë

KOLEGJIT UNIVERSITAR "INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË"

Adresa: Kompleksi Xhura, Njësia Bashkiake Nr.12, Rruga "Xhanfize Keko", Tiranë

AKADEMISË "IVODENT"

Adresa: Rruga "Prokop Myzeqari", Tiranë

KOLEGJIT UNIVERSITAR "QIRIAZI"

Adresa: Rruga "Taulantët", Kodër-Kamëz, Tiranë

KOLEGJIT PROFESIONAL TË TIRANËS

Adresa: Kompleksi Xhura, Njësia Bashkiake Nr.4, Rruga "Xhanfize Keko", Tiranë

KOLEGJIT PROFESIONAL TË LARTË, "TIRANA ESTHETICS & STYLE SCHOOL"

Adresa: Rruga "Gjeneral Nikols", Pallati Shushica, kati 1, Tiranë

DEGËS: "EPITECH ALBANIA"

Adresa: Ndërtesa 7, Tirana Business Park - Rruga e Rinasis, Tiranë

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë si institucioni përgjegjës për hartimin e politikave në fushën e arsimit të lartë, në zbatim të pikës 2, të nenit 7 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", bazuar në rekomandimin e Komitetit Teknik të Ekspertëve të datës 05.05.2021 për të zhvilluar orë konsultimi dhe provime në auditorët e institucioneve të arsimit të lartë me studentët, kërkon të merren masa nga të gjitha institucionet e arsimit të lartë, për mbylljen me sukses të vitit akademik 2020-2021, duke respektuar aktet rregullatore lidhur me masat dhe protokollet higjieno-sanitare mbi parandalimin e përhapjes së COVID-19.


Bazuar në këtë rekomandim të Komitetit Teknik të Ekspertëve, duke qenë se përgjegjësia jonë e përbashkët është shumë e lartë, për të garantuar një proces të rregullt të përmbylljes së vitit akademik 2020-2021, ku natyrisht prioriteti absolut është shëndeti dhe jeta e gjithsecilit, kërkojmë bashkëpunimin tuaj për të konsideruar masat e mëposhtme:

1. Kohëzgjatja e sezoneve të provimeve të jetë më shumë se 45 ditë, për të krijuar diferencë kohore ndërmjet provimeve, me qëllim parandalimin e grumbullimeve në mjediset e IAL-ve, si dhe për t'u më shumë mundësi studentëve për t'u përgatitur në provime.
2. Mungesat e studentëve në leksionet apo seminarët e zhvilluara "online" të mos i penalizojnë studentët për pjesëmarrje në provime, duke vlerësuar vështirësitë objektive që mund të kenë pasur një pjesë e studentëve gjatë kësaj periudhe.
3. Konsiderohet shumë e rëndësishme dhe për këtë arsye sjellim edhe një herë në vëmendjen tuaj garantimin e kushteve, për të minimizuar riskun e infektimit për studentët dhe gjithë personelin e IAL-ve. Për këtë arsye duhet që:
 - ndarja e studentëve të bëhet në grupe dhe orare të ndryshme;
 - numri i studentëve në auditore të jetë jo më shumë se 15 studentë, duke garantuar distancën e nevojshme, sipas protokolleve në fuqi;
 - kohëzgjatja e provimeve të jetë jo më shumë se një orë;
 - mbajtja e maskës të jetë e detyrueshme, gjatë gjithë kohëzgjatjes së qëndrimit në mjediset e IAL-ve;
 - higjienizimi i mjediseve në mënyrë të vazhdueshme të kryhet para dhe pas çdo provimi.

Bashkëlidhur gjeni urdhrin nr. 89, datë 10/5 2021 "Për marrjen e masave për mbarimin e vitit akademik 2020-2021 nga institucionet e arsimit të lartë", ku përcaktohen masat që IAL-të duhet të marrin me rikthimin në auditore të studentëve, për të zhvilluar orë konsultimi dhe provime, me qëllim mbylljen me sukses të vitit akademik 2020-2021.

Për sa më lart, në zbatim edhe të këtij urdhri dhe të legjislacionit në fuqi lidhur për marrjen e masave për mospërhapjen e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, kërkojmë të ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme, me qëllim mundësimin e studentëve për të qenë prezentë në institucion, sipas planeve të miratuara nga ana juaj, për të cilat duhet të informohet MASR.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.



Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 23, AL 1001, Tiranë E-mail: info@arsimi.gov.al www.arsimi.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2668 Prot.

Tiranë, më 10.5. 2021

U R D H Ë R

Nr. 89, datë 10.5. 2021

P Ë R

MARRJEN E MASAVE PËR MBARIMIN E VITIT AKADEMIK 2020-2021
NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"

U R D H Ë R O J:

1. IAL-të të marrin masa për mbarimin e vitit akademik 2020-2021 brenda datës 30 shtator të vitit 2021.
2. Në zbatim të rekomandimit të Komitetit Teknik të Ekspertëve, për hapjen e auditorëve në institucionet e arsimit të lartë (IAL) vetëm për konsultime dhe provime, IAL-të të marrin masa për:
 - a) organizimin e punës për zhvillimin e orëve të konsultimit përpara sezonit të provimeve;
 - b) secili prej titullarëve/pedagogëve të programeve lëndore të të gjitha cikleve të studimit, të hartojnë planin e organizimit të konsultimeve me studentët, për secilin program lëndor, bazuar në nevojat për orë konsultimi, sipas specifikave të programit;
 - c) vijimin e mësimdhënies on-line për mbylljen e planeve mësimore në çdo program studimi në të gjitha ciklet e studimit;
 - d) krijimin e kushteve për realizimin në auditorë të provimeve dhe përmbylljen e çdo detyrimi të mbetur për vitin akademik 2020-2021, duke përfshirë edhe ato të diplomimit;
 - e) planifikimin dhe grupimin e prezencës së studentëve në institucion, me qëllim minimizimin e numrit të tyre në auditorë, laboratorë, etj., për respektimin e distancimit social, pastrimin dhe higjienizimin e ambienteve;
 - f) zbatimin e rregulloreve të brendshme, për sjelljen e studentëve në institucion, hyrje-daljet, mbrojtjen e tyre, distancimin social, lëvizjet në institucion, si dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 23, AL 1001, Tiranë

E-mail: info@arsimi.gov.al

www.arsimi.gov.al

higjienizimin dhe dezinfektimin e rregullt të ambienteve, mbi bazën e rregullores së miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe rekomandimeve të Institutit të Shëndetit Publik,

3. Institucionet e arsimit të lartë, të hartojnë dhe paraqesin në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë brenda datës 20 maj të vitit 2021, planin e masave organizative dhe administrative, sipas përcaktimeve të këtij urdhri, në të cilin përfshijnë, numrin e saktë të studentëve që planifikohen të frekuentojnë institucionin dhe sipërfaqet në dispozicion të shprehur në m², me qëllim garantimin e distancimit social të studentëve dhe stafit akademik.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

EVIS KUSHI

